



Elbasan paguar
[Signature]

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



"TEODORI 2003" SHPK

Ne baze te ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te" si dhe te ligjit 7973, date 26.07.1995 "Per koncesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe ne infrastrukture" si dhe ligjit 8527, date 23.09.1999 "Per privatizimin e hidrocentraleve vendore"; formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "TEODORI 2003" SHPK e ortakut te vetem themelues FAIK TEODORI.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 1

"TEODORI 2003" SH.P.K. me ortakut te vetem FAIK TEODORI, i biri i Ademit, i dtl. 16.06.1954, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Niko Avrami", pall.1, shk.5, ap.1, me pasaporte Z 0032747; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "TEODORI 2003" shpk eshte ne Elbasan, lagja "Konferenca e Labinotit".

Ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare "TEODORI 2003" SHPK shpk eshte mbi 10 vjet, me te drejte riperteritje.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "TEODORI 2003" shpk eshte sa me poshte vijon:

1. Operator te prodhimit te energjise elektrike, prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te hidrocentraleve ekzistuese dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj, te kapaciteteve te vegjel e te mesem (nga 0,2-2,5MWA)
2. Transformim dhe shperndarje te energjise elektrike.
3. Ndertim-montim te impianteve te ndryshme elektrike e rrjet te tensioneve te ulet e te larte.

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themelor i shoqerise tregtare TEODORI 2003 SHPK eshte 350.000leke i investuar ne mase te plote prej Ortakut te vetem.

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te ndryshohet vetem me vendim te ortakut te saj te vetem.

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortakët ose nga eksperte te caktuar prej tyre. Por ne te gjitha rastet rezultatet e bilancit financiar duhet te behen te njohura cdo ortaku dhe gjithmone rezultati perfundimtar duhet te merret ne shqyrtim nga asambleja e ortakeve, brenda 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

NENI 7

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj, ne perputhje me rregullat ne fuqi. Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre, caktohen nga Ortaku i Vetem.

NENI 8

Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqeria tregtare TEODORI 2003 shpk eshte prone e Ortakut te vetem te saj, i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise. Administrator i shoqerise do te jete FAIK TEODORI.

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredheniet me personat e trete.

Administratori nuk mund te kryeje vetem ato detyra qe i jane lene per kompetence nga Ortaku i Vetem.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit.

NENI 10

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate veprimeve te tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin, ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 11

Marredheniet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise "TEODORI 2003 " shpk

NENI 12

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise ortakut emerone e puneson administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetentat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht Ortakut te Vetem.

MARREDHENIET E PUNES

NENI 13

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 14

Perfaqesimi i shoqerise tregtare FAIK TEODORI shpk i perket Ortakut te vetem te saj si dhe administratorit te saj z. FAIK TEODORI. Ne mungese te tij shoqeria administrohet nga perfaqesuesi ligjor me prokure te noterizuar vetem sipas tagreve te caktuara ne prokure.

KONTROLLI I BRENDSDHEM

NENI 15

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili eshte pergjegjes perpara kesaj shoqerie per qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregulle e detyres se tij.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 16

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te

detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

NENI 17

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 18

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak. Ne rast mbylljeje Ortaku i vetem vendos mbi menytrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Ne rastin e likuidimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi : SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregtar i asaj gjykate.


DISPOZITA TE TJERA

NENI 19

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga ortaku i saj.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

FAIK TEODORI



AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR TEODORI 2003 SH.P.K.

FORMIMI

Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e emertuar TEODORI 2003 shpk e ortakut te vetem themelues FAIK TEODORI, i biri i Ademit, i dtl. 16.06.1954, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Niko Avrami", pall.1, shk.5, ap.1, me pasaporte Z 0032747; madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

SELIA

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "TEODORI 2003" SHPK eshte ne Tirane, rruga "Niko Avrami", pall.1, shk.5, ap.1. Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare eshte mbi 10 vjet. Shoqeria gezon statusin e personit juridik nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te Gjykates se shkalles se Pare Tirane.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise tregtare TEODORI 2003 " shpk eshte;

1. Operator te prodhimit te energjise elektrike, prodhim i energjise elektrike me venien ne perdorim te hidrocentraleve ekzistuese dhe me ndertimin e hidrocentraleve te rinj, te kapaciteteve te vegjel e te mesem (nga 0,2-2,5MWA)
2. Transformim dhe shperndarje te energjise elektrike.
3. Ndertim-montim te impianteve te ndryshme elektrike e rrjet te tensioneve te ulet e te larte.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise tregtare eshte prej 350.000leke i investuar ne mase te plote nga Ortaku i vetem i saj.
Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

ORGANET DREJTUESE

Shoqeria tregtare TEODORI 2003 " SHPK drejtohet nga ortaku dhe administrohet i vetem FAIK TEODORI.

ORTAKU I VETEM

FAIK TEODORI

